FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

LIBRIAN

Drazhe - 10 mg
(Klordiazepoksid)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Librian dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Librian
3. Si ta merrni Librian
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Librian
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË LIBRIAN DHE PËRSE PËRDORET

Librian përmban lëndën aktive klordiazepoksid, i cili sikurse të gjitha benzodiazepinat e tjera, fuqizon efektet e acidit gama - aminobutirik (GABA) (lehtëson neurotransmetimin frenues të GABA-s) dhe të transmetuesve të tjerë frenues, duke u lidhur me receptorët specifikë benzodiazepinikë. Fuqizimi i efekteve të GABA-s shkakton frenimin e sistemit nervor qendror.
Librian, pas marrjes nga goja, përthithet pothuajse plotësisht. Ai lidhet në një shkallë të theksuar (rreth 96%) me proteinat plazmatike, ndërsa gjysmëjeta e eliminimit luhatet nga 5 deri në 30 orë. Klordiazepoksidi kalon në lëngun trunoshpinor dhe qumështin e gjirit, si edhe në placentë. Metabolitë farmakologjikisht aktivë të klordiazepoksidit janë: desmetilklordiazepoksidi, demoksepami, desmetildiazepami dhe oksazepami. Bari i pandryshuar dhe metabolitët jashtëqiten përmes urinës, kryesisht si metabolitë të konjuguar.
Librian - drazhe përdoret në:

- trajtimin afatshkurtër të gjendjeve të rënda të ankthit dhe të tensionit, të cilat ndodhin të vetme ose të shoqëruara me pagjumësi ose çregullime organike;
- mjekimin e spazmave muskulore me origjinë psikogjene dhe neurogjene;
- qetësimin e simptomave nga abstinenca akute prej alkoolit;
- qetësimin e shqetësimeve dhe ankthit para ndërhyrjeve kirurgjike.

2. PËRPARA SE TË MERRNI LIBRIAN

Mos merrni Librian:

- në qoftë se jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj klordiazepoksidit, ndaj benzodiazepinave në përgjithësi ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të drazhesë Librian;
- nëse keni insufiçiencë respiratore akute;
- nëse keni çregullime hepatike të rënda;
- në sindromën e apnesë së gjumit;
- në psikozë kronike;
- nëse keni helmim akut me alkool;
- nëse jeni në gjendje kome; gjendje shoku;
- në gjendjet fobike ose obsesive;
- në glaukomë me kënd të ngushtë;
- në *Myasthenia gravis.*

Librian nuk duhet të përdoret i vetëm në trajtimin e depresionit ose ankthit të lidhur me depresionin.

Tregoni kujdes të veçantë me Librian

Librian duhet përdorur me kujdes të posaçëm në:

- të sëmurët me çregullime të funksionit të veshkave e të mëlçisë;
- sëmundje respiratore;
- të moshuarit;
- pacientë të deprimuar me prirje vetëvrasjeje;
- pacientë me dobësim muskular;
- pacientë me çregullime të personalitetit;
- pacientë me ndryshime organike të trurit.

Gjatë mjekimit me klordiazepoksid, ashtu sikurse me të gjitha benzodiazepinat e tjera, mund të shfaqet një gjendje farmakovarësie psikike dhe fizike. Faktorët që ndikojnë në shfaqjen e varësisë janë: kohëzgjatja e mjekimit, doza, kombinimi me lëndë psikotrope, anksiolitike, hipnotike; varësia e mëparshme ndaj barnave.
Duhet të shmanget përdorimi afatgjatë dhe ndërprerja e menjëhershme.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Librian.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Librian në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:

- acid valproik, cimetidinë, disulfiram, fluoksetinë, izoniazid, ketokonazol, kontraceptivë që merren nga goja, metoprolol, propoksifen, propranolol, alkool, barbiturate, narkotikë, antiacide, probenecid, ranitidinë, rifampicin, skopolaminë dhe teofilinë, sepse këto ndikojnë në efektin e benzodiazepinave;
- digoksinë, fenitoinë, levodopa dhe bllokues neuromuskulorë, duke qenë se këto ndikohen nga benzodiazepinat.

Marrja e Librian me ushqim dhe pije

Librian nuk duhet të merret me alkool sepse kombinimi me alkool i klordiazepoksidit, ashtu si benzodiazepinat e tjera, shfaq një gjendje farmakovarësie psikike dhe fizike.

Shtatzënia

Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar.

Këshillohet mënjanimi i përdorimit të Librian gjatë shtatzënisë, veçanërisht gjatë tremujorit të parë dhe të fundit. Mjeku do të vlerësojë faktorin risk / përfitim.

Ushqimi me gji

Klordiazepoksidi kalon në qumështin e gjirit dhe prandaj nuk duhet të përdoret gjatë ushqimit të foshnjes me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Librian mund të shkaktojë përgjumje, çorientim, konfuzion dhe hipotension të ndjeshëm, çka mund të dëmtojë aftësitë e të sëmurit për të drejtuar automjetin ose për të përdorur makineri.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Librian

Ky bar përmban sukrozë. Në qoftë se keni intolerancë ndaj disa sheqernave, kontaktoni me mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI LIBRIAN

Gjithmonë merreni Librian sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj. Në qoftë se ndjeni që efektet e Librian janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Drazhetë duhet të gëlltiten me të paktën gjysmë gote ujë.
Mund t'i merrni drazhetë me ose pa ushqim.
Dozimi është si më poshtë:
Ankth, të rriturit: 5 – 10 mg, 3 herë në ditë, që mund të rritet nëse është e nevojshme në 20 mg, 3 ose 4 herë në ditë;
Të sëmurët e moshuar ose të dobësuar: 5 – 10 mg në ditë.
Spazma muskulore: 10 - 30 mg në ditë, në doza të ndara.
Shqetësim dhe ankth para ndërhyrjeve kirurgjike: 5 – 10 mg, në ditët para ndërhyrjes kirurgjike.
Abstinenca akute nga alkooli: 50 – 100 mg, që përsëritet në rast nevoje (doza maksimale është 250 mg në ditë).
Megjithatë doza mund të ketë nevojë për tu rritur ose për tu ulur. Mjeku juaj do t'ju këshillojë në përputhje me rrethanat.

Në qoftë se keni marrë më shumë Librian

Në qoftë se keni marrë më shumë Librian se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Librian nuk duhet të merret për një kohë të gjatë sepse shfaqet varësi ndaj këtij bari.

Në qoftë se harroni të merrni Librian

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).

Në qoftë se ndërprisni marrjen e Librian

Mos e ndërprisni trajtimin pa u konsultuar me mjekun.
Trajtimi nuk duhet ndërprerë menjëherë, por në mënyrë graduale, duke ulur dozën.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Librian mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Ndonjëherë ato janë serioze, ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Efektet e padëshirueshme më të shpeshta janë:

- në sistemin kardiovaskular (kolaps kardiovaskular, hipertension, takikardi, bradikardi, edemë);
- në sistemin nervor qendror (përgjumje, konfuzion, ataksi, marrje mendsh, asteni, apati, dëmtim i kujtesës, çorientim, amnezi anterograde, dhimbje koke, e folur e paqartë, humbje e zërit, shtangie, koma, eufori, irritim, ëndrra me sy hapur dhe reaksione paradoksale, p.sh. zemërim, qëndrim armiqësor ndaj të tjerëve, mani, pagjumësi, spazma muskulore);
- në aparatin tretës (konstipacion, diarre, tharje goje, të përziera, anoreksi, të vjella);
- hematologjike (diskrazi të gjakut, përfshirë agranulocitozën, aneminë, trombocitopeninë, leukopeninë, neutropeninë).

Janë konstatuar edhe çregullime të shikimit, ekzantema, çregullime në provat e funksionit të mëlçisë, hepatit, ikter, si dhe sindrom i abstinencës / varësisë.
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI LIBRIAN

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni Librian pas datës së skadencës, e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C.
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Librian

Lënda vepruese është klordiazepoksidi.
Çdo drazhe përmban 10 mg klordiazepoksid.
Përbërësit e tjerë janë: amidon, celulozë mikrokristalore, kroskarmelozë natriumi, povidon, glikolat natriumi i amidonit, karbonat kalçiumi, stearat magnezi, xhelatinë, talk, dioksid titani, sukrozë, Opalux i gjelbër, Opaglos i bardhë 6000.

Përmbajtja e paketimit

Kuti me 30 drazhe.

Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:

Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Përmbajtja. Kujdes.

Forma e tabletës.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2015.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.